



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.**63**..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 23/05/2024

VENDIM

Nr.14, datë 23/05/2024

PËR

**PROBLEMATIKAT NË LIDHJE ME SHFRYTËZIMIN, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN, MONITORIMIN DHE SIGURINË E DIGAVE TË
ADMINISTRUARA NGA BASHKITE E QARKUT DURRES**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 23.05.2024 mori në shqyrtim problematikat e konstatuara per vitin 2023 ne lidhje me shfrytezimin, operimin, monitorimin dhe sigurinë e digave te medha që administrohen nga Bashkite Durres, Kruje dhe Sjiak te qarkut te Durresit.

Bashkia Durrës nuk ka sjell asnjë informacion dhe Raport në lidhje me gjëndjen e digave që administrohen prej saj. Nga shqyrtimi i Raporteve vjetore të dorëzuara nga Bashkitë Krujë dhe Shijak vërehet se në të gjithë digat e mëdha të administruara prej tyre **nuk ka te dhëna për monitorimin real dhe me instrumenta të këtyre digave, nuk janë preqatitur plane të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile, nuk ka asnjë sistem alarmi të instaluar në këto diga** apo në zonat urbane poshte tyre, nuk jane paraqitur te dhena ne lidhje me monitorimin e integruar real te tyre. Megjithese sipas legjislacionit në fuqi kërkohet matja e volumeve aktuale të ujit dhe sedimenteve në rezervuaret e krijuar prej tyre të paktën një herë në 5 vjet, rezulton se në këto rezervuare nuk është kryer asnjë matje faktike e këtyre volumeve prej më se 30 vitesh. Mungesa e këtyre matjeve bëhet me problematike jo vetëm për menaxhimin e integruar dhe kompleks të rezervave ujore të krijuara para 40 viteve por edhe për faktin se problemet e sedimenteve duken se janë të mëdha dhe kane zvogeluar ndjeshem volumin faktik të ujit në këto rezervuarë.

Gjithashtu, në të gjitha digat e mëdha të administruara nga të tre bashkitë e qarkut Durrës nuk ka asnjë vlerësim të aseteve të digave dhe elementeve të tyre apo rregjistër të këtyre pasurive të paluajtshme. Mirëmbajtja e këtyre digave ka mjaft probleme të cilat po sjellin përkeqësimin e gjëndjes së tyre. Në shumicën e digave të mëdha, mungojnë masat për sigurine fizike të tyre dhe elementeve kryesorë të tyre.

Pas diskutimeve të të gjithe antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Ti kërkohet Bashkisë Durrës të dorëzoj brenda muajit Qershor 2024 një raport në lidhje me Gjëndjen aktuale, monitorimin, mirëmbajtjen dhe Sigurinë e digave që administrohen prej saj
- 2- Ti kërkoj Bashkive Durrës, Krujë dhe Shijak si shfrytëzuese e digave të mëdha që administrohen prej saj:
 - Të marrin masat emergjente për mirëmbajtjen dhe monitorimin e digave të mëdha përmes instalimit të sistemeve të monitorimit të këruara në nenet 32 dhe 33 te VKM përkatese të dhënë me sipër. Në kuadër të këtyre masave duhe të kihet paraysh instalimi i sistemeve të monitorimit të digave në kohe reale dhe online si dhe krijimi i bazës së të dhënave të monitorimit të digave dhe rezervuareve të krijuar prej tyre;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Të preqatitin planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për shkak të prurjeve maksimale që mund të vijnë në rezervuarin e krijuar nga diga apo prishjes së mundshme të digës. Këto plane duhet të jenë të shoqëruar me hartat e përmbytjeve sipas kërkesave të nenit 35 të VKM së mësipërme;
- Të hartojnë Rregulloret e shfrytëzimit, monitorimit dhe sigurisë së digave sipas kërkesave të nenit 29 të VKM së mësipërme. Këto Rregullore duhet të dorëzohen për shqyrtim dhe miratim pranë KKDM përparrë fillimit të periudhës ujëshumë;
- Të preqatit dhe te dorëzoj pranë KKDM një informacion në lidhje me vlerësimin e aseteve të digave dhe elementeve kryesore të tyre sipas udhëzimeve të KKDM ;
- Të kryejne matjet e volumeve aktuale të ujit në cdo rezervuar, vlerësimin e sedimenteve të grumbulluara në to dhe të hartojnë kurbat e reja të volumeve dhe të sipërfaqeve të ujit për rezervuaret deri është nivelin maksimal të ujit të parashikuar në projekt sipas kërkesave të nenit 30 të VKM së mësipërme;

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjislacionin në fuqi. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI